

Idriz (Salih) Salihu

(7.02.1955, shqiptar nga Tica, komuna e Skënderajt/Srbica, rojtar, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

Idrizi ka qenë rojtar në shkollën e fshatit. Punonte edhe në pronën familjare në **Ticë/Tica**. U bë pjesëtar i shtabit lokal të UÇK-së në fshatin fqinj të Likocit/Likovac më 30.03.1998. Për detyrë e kishte mbajtjen e rojës dhe hapjen e istikameve. Kur forcat serbe kanë hyrë në fshat më **25.09.1998**, Idrizi ndodhej në pyjet e afërta dhe e vëzhgonte terrenin. Nga ora 15:30, u nis drejt lagjes *Bekaj*, për të parë nëse forcat serbe ishin tërhequr. Te vendi i quajtur *Të ara e Riza Muratit/Riza Muratijeva njiva*, pjesëtarë të forcave serbe hapën zjarr ndaj tij dhe e plagosën në kokë dhe në gjoks. Babai i Idrizit, Salihu, i dëgjoi të shtënat dhe u nis menjëherë nga ai drejtim. Kur desh ta merrte Idrizin e plagosur, erdhën disa pjesëtarë të forcave serbe dhe nisën t'i mëshonin me kondakët në kokë. Një nga ushtarët e zbrazti një rafal mbi Idrizin e plagosur, duke e privuar nga jeta në vend. Salihun e përzunë nga vendi i ngjarjes. Në mbrëmje, vëllai i Idrizit, Hajrizi, e ka bartur trupin e të vëllait deri te vendi i quajtur *Mali i Zabelit/Planinski gaj*. Pas dy ditësh, familjarët e kanë varrosur Idrizin në varrezat e fshatit, ku ai prehet edhe sot.

Burimet: deklarata R.S, FDH-32474; J. Martinzen, *Regjistri..*, FDH-26092.

Smajl (Bajram) Millaku

(18.05.1929, shqiptar nga Siqeva/Sićevo, komuna e Klinës/Klina, bujk, katër fëmijë)

Sefer (Smajl) Millaku

(3.01.1948, shqiptar nga Siqeva/Sićevo, komuna e Klinës/Klina, bujk, pesë fëmijë)

Familja e Smajl Millakut përbëhej prej 14 anëtarësh. I biri Seferi punonte në polici deri në fillim të vjetëve të nëntëdhjeta, ndërkaq më vonë punonte në bujqësi. Kur forcat serbe e bombarduan fshatin në fillim të muajit gusht të vitit 1998 nga drejtimi i Dobërdolit/Dobri Do, të gjithë familjarët u zhvendosën në fshatin Caravik/Cerovik [Klinë/Klina]. Në mëngjes, më **25.09.1998**, Smajli u nis për në Siqevë/Sićevo, duke e

ndjekur djalin e vogël, Zeqirin, i cili kishte shkuar një orë përpara ta kontrollonte shtëpinë. Smajlin e kanë qëlluar me armë zjarri, përderisa po e kalonte vijën hekurudhore ndërmjet dy tuneleve në fshatin **Aqarevë/Ovçarevo**. Trupi i tij ka mbetur i shtrirë në shkurret pranë hekurudhës. Seferi ka mësuar ditën tjetër [**26.09.1998**] nga Ramiz Jashari nga Aqareva/Ovçarevo se të atin ia kishin vrarë. Pastaj, ata që të dy u nisën për në Aqarevë/Ovçarevo. Afro 100 metra larg vendit ku gjendej trupi i Smajlit, pjesëtarë të forcave serbe kanë shtënë me pushkë snajperi ndaj Seferit dhe Ramizit. Seferin e kanë qëlluar në zemër dhe ai dha shpirt në vend. Në mbrëmje, Zeqiri e ka gjetur rastësisht trupin e Seferit. Në të njëjtën mbrëmje, Zeqiri me djalin e Seferit, Beharin, dhe disa të afërm e kanë varrosur Seferin në vendin e quajtur *Mulliri i Geges/Gegina Vodenica* në Siqevë/Sićevo. Në mëngjesin e ditës tjetër, Zeqiri me ndihmën e djaloshit, i cili e kishte gjetur trupin e Smajlit, e ka varrosur të atin pranë Seferit. Në datën 22.11.1998, trupat e tyre u rivarrosën në varrezat e Siqevës/Sićevo.

Burimet: deklarata A.LI, FDH-26711; deklarata Z.M, FDH-15416; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 8, FDH-23857.

Hanife (Ramadan Asllani)

Jashari

(2.02.1953, shqiptare nga Aqareva/Ovçarevo, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, tetë fëmijë)

Në datën **25.09.1998**, Hanifja me vajzën dhe djalin gjendeshin në shtëpi [Aqarevë/Ovçarevo]. Rreth orës 11:00, u dëgjua krisma e armëve të zjarrit dhe, më pas, forcat serbe kanë hyrë në fshat. Hanifja u tha fëmijëve që menjëherë të niseshin me banorë të tjerë deri të përroska e afërt, përderisa ajo do të shkonte menjëherë pas tyre sa t'i përgatiste rroba dhe ushqime. Fëmijët e pritën të emën atë ditë, por ajo nuk erdhi. Tri ditë më vonë, kur forcat serbe u tërhoqën nga fshati, një banor e ka gjetur trupin e pajetë të Hanifes në *Mallin e Shkozës/Planina Škoza* [Aqarevë/Ovçarevo]. Familjarët e kanë varrosur